

**TRACES IN TERMINOLOGY PROPERTY OF ANTON M. XANONI S.J. IN HIS
WORK *GRAMATIKA SHQYP*, SHKODËR, 1909**

Armand OMERI

University of Tirana, Faculty of History and Philology, Albanian Language
armandomeri@yahoo.com

UDC 811.18' 36(091)

Conference paper

Abstract

Anton M. Xanoni S.J. is one of the most important Albanian intellectuals of the early twentieth century, with regard to linguistic science, having left a precious legacy in the field of linguistic, *Gramatika Shqyp*'s work, published by Zojes Paperlyeme in Shkodra in 1909. *Gramatika Shqyp* is structured on the basis of language disciplines and the author follows this sequence in the elaboration of the content:

Gramatika Shqyp begins with the meaning for words and letters and follows with phonetics with speeches for vowels, conjunctions, syllables and types of accents in Albanian; in the word formation field he observes and classifies the words of the formative ways; the work contains data on spelling rules, especially for the use of punctuation marks and some spelling rules for writing specific words and phrases; the central part of *Gramatika Shqyp* is the discipline of morphology, the description of the parts of the lecture and the grammatical categories of the parts of the law; there are few notions and data available in the syntax discipline.

The paper aims to bring to attention the terminology of A. M. Xanoni's *GramatikaShqyp*, as an important work in the history of Albanian language development, in the history of the scientific opinion on Albanian language and in the history of the Albanian language terms.

Key words: *Linguistic terminology, language discipline (phonetics, spelling, word formation), definition of concepts.*

Përmbledhje

Anton M. Xanoni S. J. (1862-1915) është një ndër intelektualët shqiptarë më të rëndësishëm të fillimshkullit XX, për sa i përket shkencës së gjuhësisë, pasi që ka lënë trashëgim të vyer në lëmë të gjuhësisë, veprën *Gramatika Shqyp*, botuar nga Shtypshkroja e Zojës Paperlyeme në Shkodër më 1909. *Gramatika Shqyp* është strukturuar në bazë të disiplinave gjuhësore dhe autori ndjek këtë rend në shtjellimin e përmbajtjes:

Gramatika Shqyp nis me kuptimin për fjalët dhe gërmat dhe vijon me fonetikën me shtjellime për zanoret, bashkëtingëlloret, rrokjet dhe llojet e theksave në gjuhën shqipe; në fushën e fjalëformimit autori vëzhgon dhe klasifikon fjalët për nga mënyrat fjalëformuese; vepra përmban të dhëna për rregullat drejtshkrimore, sidomos për përdorimin e shenjave të pikësimit dhe disa rregulla drejtshkrimorë për shkrimin e fjalëve dhe të trajtave të veçanta; pjesa qendrore e *Gramatikës Shqyp* është disiplina e morfologjisë, përshkrimi i pjesëve të ligjëratës dhe i kategorive gramatikore të pjesëve të ligjëratës; në disiplinën e sintaksës gjenden pak nocione dhe të dhëna.

Kumtesa synon të sjellë në vëmendje pasurinë terminologjike të *Gramatika Shqype* të A. M. Xanonit, si një vepër me rëndësi në historikun e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare, të mendimit shkencor mbi gjuhën shqipe dhe të termave të gjuhësisë shqipe.

Fjalët kyçe: *Terminologjia e gjuhësisë, disiplina gjuhësore (fonetika, drejtshkrimi, fjalëformimi), përkufizimi i koncepteve.*

Hyrje

Anton M. Xanoni në *Gramatika Shqyp* (1909) trajton disa fusha të gramatikës gjuhësore e, për rrjedhim, në këto fusha hetohet një shumësi termash të gjuhësisë. Këto terma mbajnë vulën e punës krijuese të autorit dhe ky tekst së bashku me gramatikat e hartuara nga autorë të tjerë, përbëjnë një thesar për leksikografinë dhe për terminologjinë shqiptare, për shkencën e albanologjisë. Në fund të veprës, në përmbajtjen e gramatikës, *Perkreici*, autori ka renditur kategoritë gramatikore dhe leksikore që ka marrë në shqyrtim, pa i ndarë në fusha gjuhësore.

Një ndarje në fushat gjuhësore përipiqet të bëjë kjo kumtesë, për arsye të një përshkrimi të detajuar dhe për të hetuar tërësinë e koncepteve të trajtuara dhe të termave, që mbulojnë këto koncepte. Nga analiza e *Gramatika shqyp*, hetohen këto fusha gjuhësore: drejtshkrimi, fjalëformimi, fonetika, morfologjia dhe sintaksa. Autori shtjellon pjesën teorike dhe jep shembuj; bën analiza për pjesët e ndryshme të ligjëratës dhe në fund të çdo çështjeje ndërton një aparat me pyetje për temën e shtjelluar.

Me pak fjalë, gramatika është e pajisur dhe me aparatën pedagogjik për mësimin e gramatikës së gjuhës shqipe e, për rrjedhojë, autori jep një ndihmesë në fushën e metodave të të mësuarit dhe të pedagogjisë, paçka se ky nuk është synimi kryesor i veprës së tij. Në këtë kumtesë do të pasqyrohen të gjitha konceptet dhe termat gjuhësorë që kanë të bëjnë me fushën e drejtshkrimit, të fonetikës, të fjalëformimit dhe të sintaksës, pasi konceptet dhe termat në fushën e morfologjisë do të jenë objekt i një kumtese tjetër për *Gramatika shqyp* të Anton Xanonit.

Drejtshkrimi

Që në hyrje të *Gramatika Shqyp*, Anton Xanoni formulon konceptin e tij për gramatikën, e cila “*mbëson me fol’e me shkruie mir’e drejt giuhen Shqyp.*” (Xanoni, 1909:9). Autori i është përmbajtur këtij parimi themelor të gramatikës dhe ka dëshmuar me fakte të shkruara se dhe në lëmë të terminologjisë së gjuhësisë, me termat që ka formuluar, ka shkruar mirë dhe drejt gjuhën shqipe.

Ky parim i formuluar kështu është i njëjtë me parimin e formuluar dhe nga Sami Frashëri në *Shkronjëtoe e gjuhësë shqip* (1886), 1988, fq. 9: “*Shkronjëtoe shqip është një dituri më të cilënë mësojmë të flasim’e të shkruajmë mir’e drejt gjuhënë shqip.*” Ndarja e termave në fusha është bërë për lehtësi studimi, pasi autori nuk e ka ndarë veprën e tij në fusha të veçanta. Në fushën e drejtshkrimit A. Xanoni trajton rreth 13 koncepte dhe, si rrjedhim, janë klasifikuar rreth 13 terma të fushës.

Në krye të veprës së tij, autori nuk flet për *alfabet*, si një emërtim i huazuar nga greqishtja, por për abece: *Abeceja asht t’pershtimit* (A.O.- përshkrimi) *e t’tana germave t’ndoi giuhës.*” (Xanoni, 1909:9). Autori shkruan për germa të gjuhës, jo për shkronja, dhe bën këtë përshkrim të shkronjave të gjuhës shqipe, pavarësisht se mund të ketë bërë një lapsus, një pasaktësi për numrin të zanoreve: *Giuha e jonë kaa tridhet’e gjasht germa, gjasht zantore e njizet e ndandë ndërzane.*” (Xanoni, 1909:9).

Më tej klasifikon shkronjat dhe i pagëzon (A.O.- kjo folje është huazuar nga S. Riza) me terma që vijnë nga emërzimi i mbiemrave; t’mdhaiza dhe t’imta: “*Germat e mdhaja quhen t’mdhaiza, germat e vogla quhen t’imta.*” (Xanoni, 1909: 9). Vihet re se A. Xanoni i përdor të dyja emërtimet për germat në fjalinë sqaruese ose përkufizuese për ato: “*germat e mdhaja, të vogla*”; kështu që termat që vijnë nga emërzimi kontekstual janë sinonime me termat që përdoren rëndom. Autori jep rregulla të drejtshkrimit të gjuhës, duke qenë ndër të parët gjuhëtarë që punon për të saktësuar normën e drejtshkrimit të gjuhën shqipe.

Xanoni shkruan germa “s”, në një kohë që kjo njësi nuk është gërmë, por pjesëz mohuese, sipas gramatikës së gjuhës shqipe sot; megjithatë ai e di kuptimin e fjalëzës, por nuk e emërton “pjesëz”; kështu Xanoni shkruan: “Germa “s” don me thanë: jo, e s’ka zantore në vete e i pështetet fjalës që i vjen mbrapa, e prashtu nuk shifet arsyeja pse me ja një hijezen: do shkruar pra: s kam e jo s’ kam, por zakoni e ka qit punën ndryshe.” (Xanoni, 1909:16). Kjo është një përpjekje e autorit për të kodifikuar drejtshkrimin duke u nisur nga parimi morfologjik.

Në trajtimin e shenjave të pikësimit autori përdor terminologji nga fjalë shqipe. Për shenjën e apostrofit, term i huazuar nga greqishtja, Xanoni krijon termin hijeza, që “është një shenjë (‘) që u vihet nderzaneve ç, m, n, nd, t, në kambë të ndonjë rrokjeje ose të një zantoreje: ç’âsht çka âsht, n’m’ardhshin në më ardhshin.” (Xanoni, 1909:16). Saktësia për të dhënë kuptimin e shenjës dhe shembujt për përdorimin e saj janë një tjetër përpjekje dhe ndihmesë në mendimin shkencor për gjuhësinë shqiptare.

Pikësimi, si element i rëndësishëm i drejtshkrimit të një gjuhe, vjen në *Gramatikën Shqyp* të Xanonit me emërtimin piksia, shenjet e pikave, shenje piksijet (Xanoni, 1909:20). Emërtimi i shenjave të pikësimit është i njëjtë me ato që përdorim sot: dy pikat (:), pikpresa (;), presa (,) pikpvetie (?), pikçuditie (!), me përjashtim të emërtimit të shenjës së pikës (.), të cilën autori e emërton në mënyrë origjinale ndala (Xanoni, 1909:20), e afërt për nga kuptimi me fjalën “ndalesa”. Kuptohet se autori në krijimin e termave mban parasysh parimin e lëshimeve apo të lirive në fjalëkrijim, ndryshimin e trajtës morfologjike të fjalës, me qëllim që të krijojë një shenjë të re për të mbuluar një nocion a koncept terminologjik.

Fonetika

Autori trajton në *Gramatika Shqype* rreth 27 koncepte të fushës së fonetikës; koncepte që shprehen me terma njëfjalësh dhe me togfjalësha terminologjike. Fusha e fonetikës është e gjerë dhe në gjerësinë e saj të studimit ajo përfshin një shumësi konceptesh, që shprehen me një shumësi termash. Megjithatë Xanoni ka meritën se sjell një hulumtim gjuhësor më të gjerë, në krahasim me paraardhësit; bien në sy kontaktet e Xanonit me literaturën e huaj të gjuhësisë.

Kalkimi ose shqipërimi i termave të gjuhësisë është një proces i parapëlqyer për A. Xanonin dhe duket se, përpos kërkesave shkencore për hartimin e *Gramatikës Shqype*, ai ka gjakuar edhe pasurimin e terminologjisë së gjuhësisë shqipe, duke ecur në gjurmët e rilindasve. Dy kategoritë e mëdha të tingujve të të folurit, zanoret dhe bashkëtingëlloret, Xanoni i emërton përkatësisht zantore (Xanoni, 1909:9) dhe nderzane (Xanoni, 1909:12).

Nderzanet janë tinguj zhurma që nuk shqiptohen dot pa u shoqëruar me tingujt zanorë; për këtë veçori akustike dhe shqiptimore Xanoni do t’i ketë pagëzuar me termin “nderzane”.

Këtë konstatim e ndeshim te pohimi i Anastas Dodit në *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, 2004, fq. 36, ku shkruan se “vetë termi bashkëtingëllore tregon rolin e bashkëtingëllores në rrokje si shoqëruese e zanores.” Vërehet ngjashmëri me termat samianë zëtoze ose e zëshme. Po kështu vërehet ngjashmëri në mes të termit të Samiut të përzëshme dhe termit të Xanoniit nderzane.

Kanë të ngjashme mënyrën fjalëformuese me parashtesë dhe me temën fjalëformuese zë (dialekti toskë), za (dialekti gegë). Xanoni e ka njohur dhe e ka studiuar *Shkronjëtoze e gjuhësë shqip* të Samiut, pasi në fq. 44 të *GramatikaShqyp* i referohet veprës së S. Frashërit. Në ndarjet e nderzaneve (bashkëtingëlloreve) sipas vendit të nyjtimit terminologjia shqipe përbën një trashëgimi të vyer në studimet fonetike në gjuhësinë shqiptare. Xanoni shkruan për nderzanet buztore (b, p, f, m, v); nderzanet qellzore (ç, gj, q, j, nj, xh); nderzanet dhambtoze (c, d, t, dh, th, n, nd, s, z, x); nderzanet gryktore (g, k, h, ng); nderzanet giuhtore (l, ll, r, rr); nderzanet fishkllore (sh, zh) (Xanoni, 1909:12).

Togfjalëshat terminologjike të mësipërm janë të njëjtë me terminologjinë e përdorur nga S. Frashëri, me përjashtim të termit “nderzanet giuhtore”, i cili mungon tek *Shkronjëtoze e gjuhësë shqip*. Fonetika sot i klasifikon si *likuide* (të lëngëta) nderzanet giuhtore, por Xanoni është më pranë emërtimit, po të nisemi nga organi që merr pjesë në nyjtimin e këtyre bashkëtingëlloreve. Në përshkrimin fonetik për zanoret gjenden katër emërtime terminologjike: zantoret t’dyzue me për “zanore të gjata”; “zantoret e gjata shkruhen me zantore të dyzue me: aar, zâa, eer, rêe, oor, uur, hûu, dyyll, syy.” (Xanoni, 1909:11).

Gjatësinë si tipar të zanoreve që varet nga theksi apo nga pozicioni i zanores në fjalën e dhënë, Xanoni e shpreh me një emërtim terminologjik që mban parasysh trajtën shkrimore të zanores. Drejtshkrimi sot nuk e pasqyron gjatësinë e tingujve zanorë me dyzim të zanoreve në trajtën e shkruar. Për këtë arsye emërtimi zantoret t’dyzue nuk gjendet në trajtesa shkencore për gjuhësinë. Për konceptet “zanore e theksuar”, “zanore e patheksuar”, Xanoni shkruan respektivisht: zantore kumbuese, d.m.th. zantoria ku bie theksa quhet *kumbuese*; tjerat *pakumbuese*, d.m.th. zantore pakumbuese.” (Xanoni, 1909:14-15).

Mbiemri “kumbues” është sinonim me ushtues, buçitës, gjëmues, jehues, tingëllues etj. Termi “kumbimi” është përdorur në disa kuptime nga Xanoni dhe krijon paqartësi për nocionin që mbulon:

a) Xanoni përdor termin kumbimi i zantoreve me kuptimin “ton ose tingëllim”. “Gjith e cilla (A.O.- secila) zantore e kaa kumbimin e vet; ndërzanet s’e kan, e prandej per m’u shqyptue do t’i pshteten ndoj zantores.” (Xanoni, 1909:9-10).

b) Xanoni përdor termin kumbim me kuptimin “gjatësi ose tingëllim”. “Zantoret e kanë kumbimin tri mënyrësh: të shkurtër (asht, ec, i, los, kusht, mbys); të përgjyhtë (ashtë, ecë, ikë, mbyhtë); të gjatë (aar, qee, liir, oor, guur).” (Xanoni, 1909:10).

c) Xanoni përdor termin kumbimi i nderhundët me kuptimin “mënyrë shqiptimit, nyjëtim apo tingëllim”: “Kumbimi i zantoreve mund të jetë i ndërhundët, e atbotë u vihet përsipër theksë hundëta (˘): âsht, vënd, hîn, hûndë.” (Xanoni, 1909:10). Xanoni ndërton saktë termin “i ndërhundët”, pasi ajri në nyjëtimin e zanoreve hundore kalon nëpër kanalën hundor, nëpër hundë.

Xanoni krijon termin zantorja e pazane për zanoren ë dhe sqaron se “*ee-ja (ë) Ee-ja (ë) e pazane që vendoset pas një ndërzane, vëhet me dit se kumbimi i zantores që ndërzania e ka lënë mbrapa, është e përgjyhtë: dialë; kjo ë me dy pika sipër kallzon se zantoria a, që ndërzania e ka lënë mbrapa, zgjatet një fice. Prandaj kumbimi i përgjyhtë shënohet gjithherë me këtë ë të pikueme, që vëhet në mbarim të fjalës.*” (Xanoni, 1909:10). Arsyetimi i mësipërm është paksa i paqartë. Në këtë argumentim fjala “kumbim” nuk ka kuptimin “theksimi”, por “tingëllimi ose shqiptimi”.

Kjo zantore e pazane ka mundësi të jetë zanorja e shtatë, që plotëson numrit 36 të germave të abecësë shqip (Xanoni, 1909:9), por që autori nuk e numëron si zanore. Dhe termi theksë kumbuese është i diskutueshëm, në mos është i pakuptimtë. Xanoni shkruan: “Theksë kumbuese është pushimi i zërit mbi ndonjë rrokje duke shqiptuar ndonjë fjalë, sikur: *drandishte, njiktà*. Zantoria ku bie theksa quhet *kumbuese*; tjerat *pakumbuese*” (Xanoni, 1909:14-15). Termi “kumbim” është i diskutueshëm; në ndonjë përdorim është dhe i pakuptimtë.

Termi theks e rande (˘) është sinonim me termin “theksi dinamik” në fonetikën e gjuhës sot. Dhe në këtë koncept Xanoni shkruan theks e rande ose theksë e shkrueme që “*është shenja me të cilën tui shkruet diktohet theksa kumbuese e disa fjalëve: njità, njitù e i thonë theks e rande (˘). Kjo theks e vumun mbi zantoren e ndonjë rrokjeje, bën që fjala të shqiptohet fort e shkurt e të mos merret një fjalë për një tjetër: njità, njita (a.o.- ngjita); qità, qita.*” (Xanoni, 1909:15). Për kohën kur shkruante Xanoni, shkrimi i fjalëve të veçanta me shenjën e theksit mbi zanore ka qenë normë drejtshkrimore, përbënte traditë shkrimore, kurse drejtshkrimi i gjuhës sot nuk e ka normë këtë rast përdorimi.

Megjithatë, termi “theks e shkrueme” qëndron, po të merret parasysh drejtshkrimi i gjuhëve të tjera që e shënojnë theksin mbi fjalë, p.sh., në drejtshkrimin e gjuhës greke. Në përkufizimin e nocionit rrokia Xanoni shkruan se “*rrokia është se e cilla copë nder t’cillat mundet m’u daa fjala naturisht.*” Në vazhdim përkufizimi i tij nuk bën dallim nga përkufizimi

i Samiut për rrokjen në atë që “*Rrokia ndërtohet me germa që shqiptohen së bashku me një të qitur të zërit, me një çast.*” (Xanoni, 1909:13).

Ndërsa emërtimet terminologjike për rrokjen, të listuara më posht, nuk i gjejmë në gramatikën e gjuhës shqipe sot. Këto janë: rrokia e simplert “*është ajo që është e bërë me një zantore të vetme a me një zantore e me një nderzane: a-na-ve*”; rrokia e bashkanjitun “*është ajo që kap ma se një nderzane: tra-pi, stro-full*”; rrokia dyzantore “*quhet rrokja që ka dy zantore: prei, lulzoin*” (Xanoni, 1909:14). A. Xanoni me termin rrokia dyzantore mund të ketë pasur parasysh konceptin “diftongu”.

Për pozicionin e theksit në fjalë Xanoni përdor një terminologji origjinale. Termat që ndërton autori kanë të bëjnë më shumë me mënyrën e shqiptimit të fjalës, ndërsa shpjegimin për llojin e theksit e lidh me përcaktimin e pozicionit të theksit në raport me rrokjet që e përbëjnë fjalën. Fjalët me theks fundor i emërton fial’ e kputme: “*është ajo fjalë që theksin e ka mbi zantoren me të cilën mbaron: edhè, vanò*”; fjalët me theks parafundor i emërton fial’ e plante: “*i thonë asaj që theksin e ka mbi t’paramramen rroke: lùle, kerkòni.*”; fjalët me theks tejfundor i emërton fial rrrshitse “*kur i bie theksa mbi të parën paramramen rroke: tallàzeve, t’ ndòlluna.*” (Xanoni, 1909:15).

Për terminoelementin “e kputme” nuk gjendet ndonjë fjalë sinonime që të motivojë përdorimin e tij, por autori duket se ka parasysh shpejtësinë, me të cilën shqiptohet kjo kategori fjalësh. Terminoelementi “e plante” ka sinonim fjalët “i sheshtë, i qetë”, ashtu siç shqiptohen në të vërtetë fjalët me theks parafundor në gjuhën shqipe. Dhe për terminoelementin “rrshitse” nuk gjendet ndonjë fjalë sinonime që të motivojë përdorimin e tij.

A. Xanoni përdor për dukurinë fonetike të rënies së tingujve termin fialë t’këputuna, ashtu si për fjalët me theks fundor, në vend që ta pagëzonte me një tjetër emërtim. Dukuria e termave homonimë sjell paqartësi në shprehjen e koncepteve shkencore. A. Xanoni shkruan: “*I thonë fjalë e këputun asaj prej së cilës hiqet nderzània ku fillon ndo ku mbaron: me’ i here; n’ vend me thanë; kush â “kush âsht”. Këputet nganjëherë ndërzanìa me i dhanë fjalës ma hije e shpejti.*” (Xanoni, 1909:15).

Autori bën sqarime për përdorimin stilistik të gjuhës, dhe kjo mbetet për t’u vlerësuar. Emërtimi terminologjik i përdorur nga Xanoni është një formulim bazuar në ligjërimin popullor, por dukuria e homonimisë krijon paqartësi në përcaktimin e konceptit.

Fjalëformimi

Fjalën, njësinë themelore të gjuhës, Xanoni e përkufizon kështu: “*Per me fol’e me shkruë perodoroim fialët: fialët qi shqyptohen, janë ndertue me kumbimet: fialët qi shkruhen, janë ndertue me germa.*” (Xanoni, 1909:9). Në këtë përshkrim, termi “kumbime” ka kuptimin e

termit “tingujt e ligjërit”. Klasifikimet fjalë njirrokse, fjalë shumrrokse (Xanoni, 1909:14) bashkë me emërtimet terminologjike Xanoni i ka marrë nga Samiu.

Në fushën e fjalëformimit Xanoni përdor termat i simplertë dhe i bashkanjitur; gramatika e gjuhës sot ka termat përgjegjës “i thjeshtë” dhe “i përngjitur”. Terminoelementin “i simplertë” autori e ka marrë nga frëngjishtja “*mot simple*: fjalë e thjeshtë” dhe ia përshtat morfologjisë shqipe. Kështu kemi këta terma:

adiektiva t’ simplert, adverb i simplert (*në qoftë se është i bërë me një fjalë të vetme: ktu, sot, neser, mirë, tash, kurr.*) (Xanoni, 1909:158); interekcione të simplerta (A.O.- pasthirrma të thjeshta) *ah! eh! oh! Oo! Or! Ore! Au! More! Moi! Mori! Of! Eh-hee! Ojii! Pupu! Popo! Bobo! Pale! Haut! Ohaa! Ohoho! Na! Ohshe! Uh! Ei! Pii! Urra! Rrnoft!* (*n’u bâishin me një fjalë t’vetme*) (Xanoni, 1909:166).

adiektiva t’ bashkanjitur, adverb i bashkanjitur (*në qoftë se është bërë me fjalë më shumë: perpara, permrapa, mbasandej, tekndei etj.*) (Xanoni, 1909:159); Nëse për mbiemrat termi “adiektiva t’ bashkanjitur” mbetet i pasaktë; termi “adverb i bashkanjitur” për ndajfoljet është me vend.

interekcione të bashkanjitura (*oh t’ lumtë! ai sot e sot! Me shndet e jetë! He t’ lutem! He de!*) (*n’u bâishin me fjalë mâa se një fjalë*) (Xanoni, 1909:166). Dhe në këtë rast terminoelementi “të bashkanjitura” nuk është i saktë, po të shikohen shembujt që jep autori; shembujt janë lokucione pasthirmore. Ndërsa termat rrokia e simplert dhe rrokia e bashkanjitur (Xanoni, 1909:14), siç u vu re më lart, janë klasifikime dhe përcaktime të panevojshme.

Folja “mbaron” është sinonime me foljen “mben, meen” në dialektin gegë. Nga kjo folje Xanoni krijon emërtimin vetjak meemi (Xanoni, 1909:102), d.m.th. *mbaresë, mbetje*. Mund ta ketë krijuar termin duke u nisur nga emërzimi i mbiemrit prejjesor “i meem”, “i meemi” dhe më pas “meemi”.

Termin shtojë Xanoni e formulon pa asnjë ndryshim si përkufizimi i Samiut duke ndryshuar vetëm foljen e marrë si shembull. Me këtë term autori nënkupton “prapashtesën” dhe “mbaresën” foljore. “*Shtojë i thonë copës së verbit që shtohet me e tregue kohën, mëndyrën, vehtien, numrin. Në verbat fillue, filloi, fillova, fillohet, copa fill është rrënja, copa ue, oi, ova, ohet janë shtoje.*” (Xanoni, 1909:124).

Ashtu si Samiu, Xanoni përfshin në një term dy koncepte të ndryshme: prapashtesën foljeformuese dhe mbaresën foljore. Termi “shtojë” është sinonim me fjalën “shtesë”, e cila është përdorur më pas nga gjuhëtarët për të krijuar termin “ndajshesë”.

Përfundimi

Duke lënë mënjanë fushën e morfologjisë, e cila do të jetë objekt hulumtimi në një tjetër kumtesë, nga një analizë e shpejtë statistikore del se termat në të katër fushat e hulumtuara; qofshin terma njëfjalësh, qofshin togfjalësha terminologjike, qofshin terminoelementë, të gjithë janë terma të gjuhësisë të ndërtuara me fjalë të gjuhës shqipe; 45 emërtime terminologjike janë albanizma dhe vetëm 5 emërtime terminologjike janë terma të huaj. *Gramatika Shqyp* 110-vjeçare e Anton Xanonit së bashku me fjalorin terminologjik që mban brenda janë një trashëgimi e vyer që vjen e freskët në ditët e sotme.

Bibliografia

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1973). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1976). *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II*, Tiranë.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1988). Sami Frashëri, *Shkronjëto e Gjuhësë Shqip*, Tiranë.
- Botime Françeskane (2006). At Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Fonetikë-Morfologji, Botimi I, Shkodër.
- DODI, A. (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- RIZA, S. (2009). *Vepra të zgjedhura*, Tiranë.
- XANONI, A. (1909). *Gramatika Shqyp*, Shkodër.